



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:234473

Datë: 16.09.2024

Numri i dokumentit: 06166032

C-IV-13-0842

Ankuesja

M K, Prizren.

E paditura

N.SH “NGLB- Kosova”, Prizren, (në likuidim), e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. “Driton Hoxha”, nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Ganimete Puka, me 16 shtator 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e ankueses dhe ndryshohet Vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit, nr. PRZ029-0151 i datës 30.maj.2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

II. OBLIGOHET AKP– Autoriteti i Likuidimit të N.SH-së në likuidim, që në emër të dëmshtëpërblimit për ndërprerjeje të parakohshme të kontratës së punës, t’ia paguaj ankueses **M K** shumën prej 702.65.00 €uro , dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t’i paguaj shumën prej 70.2€.

III. Shuma e aprovuar si në pikën II të dispozitivit do të përmbushet në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 07 qershor 2013, ankuesja dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimeve nr. PRZ029-0151, të datës 30 maj 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar dëmshtëpërblim për ndërprerjeje të parakohshme të kontratës në shumën prej 702.65 euro. Ankuesja pohon së AL,

në vendimin e saj gabimisht ka konstatuar së ankuesja nuk figuron si punëtore e NSH. Ankuesja ka pohuar së nga 07.01.1966, deri me dt.24.02.2005, ka qenë punëtore e NSH/së, dhe ka përvoje pune 39,13 vjet efektive, si dhe është e përfshirë edhe në listën e punëtorëve për gëzimin e të drejtës 20% . Ankuesja me tej propozon që të rishqyrtohet vendim i AL dhe të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesa e saj.

Ankuesja si provë ka dorëzuar vërtetimin për përvojën e punës, Vendimin e kundërshtuar të AL, njoftimin për shkëputje të kontratë së punës.

Me 05 dhjetor 2016, e paditura AKP-ja parashtrroi mbrojtje në ankesë, në të cilën i përmbahet qëndrimit se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike, dhe të dispozitave ligjore. E paditura konstaton se ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimin së procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Ashtu që parashtruesi nuk ka përcaktuar asnjë shkelje të dispozitave të Ligjit nr.04/L-034, në vendim por thjesht deklaron së ka qene një punonjës i NSH-së deri në privatizimin e saj. Gjithashtu e paditura konstaton së ankesa është e pabazuar, ashtu që për të përmbush kushtet për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies se punës, ky i fundit së pari duhet të dëshmoje së ofronte shërbime për NSH-në, pra ishte një punonjës aktiv i saj duke u paguar për shërbimet e ofruara dhe me pas, kjo marrëdhënie aktive e punës iu ndërpre si pasoje e privatizimit apo likuidimit. Në rastin konkret ankuesja nuk ka ofruar shërbime pune për NSH-në në 12 muajt e fundit para privatizimit të saj më 25.02.2005. Në lidhje me listën e 20% të cituar nga parashtruesi, e paditura i mbahet qëndrimit së hartimi i listës se 20% që liston punonjësit të cilët përfitojnë nga procesi i Privatizim/ Likuidimit të NSH-së, është një procedure ligjore tërësisht specifike e rregulluar nga një akt ligjor i veçante- Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13 dhe kjo nuk prek të drejtën e Parashtruesit për të kërkuar paga apo jo. Nga këto kritere si dhe duke pasur parasysh që shumica e këtyre NSH-ve pas vitit 1999 ishin jo stabile financiarisht, rrjedh se shumica e punëtorëve për pasoje të mos evidentimit të tyre në listat e pagave deri në privatizim/ likuidim, nuk do të arrinin të kualifikoheshin për këto lista. Prandaj për të mos iu mohuar të drejtën e këtij lloji të veçante të përfitimit nga 20%-shi si pasojë e shumë viteve përvoje pranë NSH-së. Parashtruesi figuron në këtë liste përkundër faktit së nuk ofronte shërbime për NSH-në në periudhën para privatizimit. Ashtu që, e paditura i propozon gjykatës të refuzojë ankesën si të papranueshme apo të pabazuar dhe te vërtetoj vendimin e AL-së. E paditura AKP, si provë ka dorëzuar listën e pagave të punëtorëve, për vitin 2004-2005.

Më 04.janar.2017, ankuesja në përgjigje ndaj mbrojtjes së AKP, ka mbet në tersi pran ankesës duke kërkuare shumën pre702.65€, me pretendimin se nuk qëndrojnë pretendimet e ngritura nga e paditura, me propozim që ankesa ti aprovohet në tersi si e bazuar.

Me 31.janar.2017, e paditura AKP, në kundërpërgjigje, ka mbet në tersi pranë mbrojtjes së dhënë me shkrim me propozim që ankesa e ankuses të refuzohet në tersi si e pa bazuar.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsvetimi ligjor:

Ankesa aprovohet si e bazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 76.7 i Ligjit të Punës nr. 03-L-212 (si ligj në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) thotë që: *Kompensimi i menjëhershëm në para, u paguhet të punësuarve me kontratë me periudhë të pacaktuar në ditën e ndërprerjes së kontratës, sipas kësaj shkalle:*

- 7.1. nga dy (2) deri në katër (4) vite të shërbimit, një (1) pagë mujore;
- 7.2. nga pesë (5) deri në nëntë (9) vite të shërbimit, dy (2) paga mujore;
- 7.3. nga dhjetë (10) deri në nëntëmbëdhjetë (19) vite të shërbimit, tri (3) paga mujore;
- 7.4. nga njëzet (20) deri në njëzetëntë (29) vite të shërbimit, gjashtë (6) paga mujore;
- 7.5. nga tridhjetë (30) vite të shërbimit ose më shumë, shtatë (7) paga mujore;

Baza ligjore për dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së punësimit ekziston në Neni 40.1.6.2. i shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në, i cili parasheh që punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës nëse “ janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në ”. Privatizimi është një ndër veprimet e AKP-së të parapara me nenin 6.2.1 të Ligjit për AKP-në, prandaj kërkesa për dëmshpërblim e ankueses për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës është vlefshme dhe e bazuar, dhe u vendos sikur në pjesën aprovue të aktgjykimit.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton si në vijim.

Gjykata gjen se Agjencia Kosovare e Privatizimit – AL në rastin e vendosjes së kërkesës të ankueses për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 702.65€, në vendimin e saj nr. PRZ029-0151 i datës 30.maj.2013, pa ndonjë arsye këtë kërkesë e ka refuzuar si të pavlefshme dhe pa dhënë më këtë rast ndonjë arsyetim të bazuar. Arsyetimi i vendimit nga ana e AKP-së, se ankuesja nuk është përfshirë në lista e pagave për muajt e fundit para datës së privatizimi, dhe ankuesja nuk ishte punëtor aktiv i NSH, si dhe ankuesja si duket nuk është pushur nga puna si pasojë e një veprimi të ndërmarr nga Agjencia, siç parasheh nenin 6.1 apo 6.3 i ligjit të AKP.

Gjykata gjënë së një arsytim i tillë i vendimit të AL, është në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës , për çka edhe duhet ndryshuar.

Nga gjendja faktike e vërtetuar, gjykata nxjerr përfundim se ankuesja , ishte punëtore e NSH-së deri në kohën e privatizimit të saj , dhe atë nga vitin 1966 deri me 24.02.2005, dhe kishte përvojë punës me tepër së 30 vite, që provohet nga vërtetimi nr.5/2005, dt 24.02.2005, lëshuar nga NSH, dhe asaj i takon e drejta në dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën kërkuar dhe të aprovuar .

E paditura as në vendimin e saj e as në mbrojtje në ankesë nuk e ka kontestuar ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe as lartësinë e pagesës për dëmshpërblim të ankueses, prandaj nuk ka nevojë të provohet me tepër.

E paditura si në vendimin e saj, dhe në mbrojtje në ankesë, e ka ngrit pretendimin se ankuesja nuk ishte e përfshirë si punëtor aktivë në listën e pagave për 12 muajt e fundit . Për gjykatën një pretendim i tillë i të paditurës nuk qëndron, për faktin se nga listat e pagave të dorëzuar nga vetë e paditura, ankuesja është e përfshirën në listat e pagave dhe figuron më numër nr. rend.149, dhe nga e gjithë kjo, gjykata konsideron se ankuesja ka arritur që të dëshmoj të drejtën në kompensim, sipas nenit 40 paragrafi 1.6 pika 1.6.2, të Shtojcës së Ligjit për AKP.

Për të arritur në këtë përfundim se ankuesja ka ofruar shërbime punë për NSH deri në ditën e privatizimit të NSH-së, u provua edhe nga Njoftimi i dt.24.02.2005, ku ankuesja ishte njoftuar nga AL, së për shkak të shitjes së aseteve të NSH/së, punësimi i juaj ndërpritet menjëherë, dhe në pasuesin e mëposhtëm të njoftimit është udhëzuar ankuesja së pagat e juaja sipas kontratës së punës janë përgjegjësi e punëdhënësit.

Në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Ganimete Puka,

G j y q t a r e